

VENDIM
Nr. 866, datë 30.12.2024

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITET
PUBLIK PRIVAT, PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN, REHABILITIMIN DHE TRANSFERIMIN E SEGMENTIT
RRUGOR KASHAR-PEZË-LEKAJ NDËRMJET MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE
EKONOMIKË “GJOKA KONSTRUKSION” SHA, “JUNIK” SHPK, “COBIAL”
SHPK, “PEPA GROUP” SHPK, “UDHA” SHPK, “GEOPORTAL” SHPK, DHE “A&E
ENGINEERING” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 9, e 41, pika 2, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Kashar-Pezë-Lekaj ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a., “Junik” sh.p.k., “Cobial” sh.p.k., “Pepa Group” sh.p.k., “UDHA”, sh.p.k., “Geoportal” sh.p.k., dhe “A&E Engineering” sh.p.k., që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku